




BULETIN

BASHKIA ELBASAN



NUMËR 3 - SHKURT 2023
ISSUE 3 - FEBRUARY 2023

KËSHILLI VENDOR I SIGURISË PUBLIKE,
NË BASHKINË ELBASAN

T'I PËRGJIGJEMI SFIDAVE TË SIGURISË DHE MBROJTJES ME PRIORITET

LOCAL PUBLIC SECURITY COUNCILS (LPSC),
IN ELBASAN MUNICIPALITY

RESPONDING TO SAFETY AND PROTECTION CHALLENGES WITH PRIORITY

3

BULETIN INFORMATIV I KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE, BASHKIA ELBASAN

Bashkia Elbasan

Bashkia e re e Elbasanit kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Librazhd, në jug-lindje me bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me bashkinë Gramsh dhe në perëndim me bashkitë Cërrik dhe Peqin. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Elbasanit. Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 141,714 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 205,892 banorësh dhe me densitet prej 236.11 banorë për km². Bashkia e Elbasanit ka një sipërfaqe prej 872,03 km². Kjo bashki përbëhet nga 13 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra e cila është një nga më të mëdhatë në Shqipëri, si dhe një nga bashkitë më komplekse për t'u administruar



RAYS

Reconnecting Albanian Youth and Society

Ky buletin u publikua me mbështetjen e projektit RAYS, i cili zbatohet në Shqipëri nga Palladium. Përmbajtja e buletinit jo domosdoshmërisht shpreh qëndrimet e projektit apo partnerëve që e zbatojnë.

INFORMATIVE BULETIN OF THE LOCAL PUBLIC SECURITY COUNCILS (LPSC), ELBASAN MUNICIPALITY

Elbasan municipality

The new municipality of Elbasan borders to the north with the municipality of Tirana, to the east with the municipality of Librazhd, to the south-east with the municipality of Prrenjas, to the south-west with the municipality of Gramsh and to the west with the municipalities of Cërrik and Peqin. According to the 2011 Census, this municipality has 141,714 inhabitants, while according to the Civil Registry it has a population of 205,892 inhabitants and a density of 236.11 inhabitants per km². The municipality of Elbasan has an area of 872.03 km². This municipality consists of 13 administrative units. The new municipality has under its administration a city and 116 villages, which is one of the largest in Albania, as well as one of the most complex to administer.

This newsletter was published with the support of to the RAYS project, which is implemented in Albania from Palladium. The content of the newsletter does not necessarily expresses the attitudes of the project or the partners who implement it.

NË BRENDËSI

4	FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT TË BASHKISË ELBASAN, Z. GLEDIAN LLATJA
6	FJALA PËRSHËNDETËSE E Z. MICHELE RIBOTTA, PËRFAQËSUES I UN WOMEN ALBANIA
8	FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË DREJTORISË VENDORE TË POLICISË ELBASAN, Z. ARDIAN ÇIPA
12	RËNDËSIA E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË ELBASAN
14	FORUM I HAPUR ME TË RINJTË E QYTETIT TË ELBASANIT
16	KËSHILLI VENDOR I SIGURISË PUBLIKE NË 1 VIT
18	AKTIVITETE

INSIDE THIS ISSUE

5	WELCOME SPEECH OF THE MAYOR OF THE MUNICIPALITY OF ELBASAN, MR GLEDIAN LLATJA
7	WELCOME SPEECH OF MR MICHELE RIBOTTA, REPRESENTATIVE OF UN WOMEN ALBANIA
10	WELCOME SPEECH OF THE DIRECTOR OF THE LOCAL POLICE DIRECTORATE OF ELBASAN, MR ARDIAN ÇIPA
13	THE IMPORTANCE OF THE LOCAL PUBLIC SAFETY COUNCIL IN ELBASAN MUNICIPALITY
15	OPEN FORUM WITH THE YOUNG PEOPLE OF THE CITY OF ELBASAN
17	LOCAL PUBLIC SAFETY COUNCIL IN 1 YEAR
30	ACTIVITIES

TË NDERUAR LEXUES



Si një mjet kritik për të përmirësuar vazhdimisht përpjekjet tona për rritjen e sigurisë, palët e interesuara në nivel lokal e përtej duhet të angazhohen nëpërmjet partneriteteve dhe punës shumë aktoriale, për të dëgjuar, mësuar dhe reaguar më me efikasitet ndaj të gjitha sfidave dhe kërcënimeve.

z. Gledian Llatja

Kam kënaqësinë që të paraqes përpara jush numrin e 3të Buletinit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike. Si Kryetar i Bashkisë Elbasan dhe njëkohësisht i mekanizmit të KVSP, vlerësoj si shumë të rëndësishëm komunikimin tonë të përbashkët në identifikimin dhe adresimin e sfidave shqetësuese për të gjithë ne, ku ky mekanizëm shërben edhe si një urë ndërlidhëse për të qenë më pranë njëri tjetrit.

Në këtë numër, ju do të keni mundësinë që të njiheni nga afër me rëndësinë dhe aktivitetet e zhvilluara nga ky mekanizëm si edhe disa prej nismave shumë të rëndësishme të ndërmarra nga Bashkia Elbasan, sikurse është ajo për zhvillimin e vullnetarizmit të qëndrueshëm, forcimin e marrëdhënieve me diasporën, zhvillimi i partneriteteve të reja dhe fuqizimi i atyre ekzistuese, rritja e bashkëpunimit me aktorët lokalë si edhe përfshirja dhe fuqizimi i të rinjve në vendimmarrje.

Në faqet në vijim, do të njiheni me punën e jashtëzakonshme dhe arritjet që të gjithë anëtarët e këtij mekanizmi dhe bashkëpunëtorët tanë bëjnë për të identifikuar dhe adresuar sa më me efektivitet sfidat e lidhura me sigurinë, duke mbështetur çdo nismë që parandalon dhe lufton faktorët që çënojnë sigurinë. Ne vlerësojmë se, nëpërmjet këtij mekanizmi, partnerët tanë kanë gjetur një

mënyrë shumë të mirë për të rritur efikasitetin e punës së tyre.

Si një mjet kritik për të përmirësuar vazhdimisht përpjekjet tona për rritjen e sigurisë, palët e interesuara në nivel lokal e përtej duhet të angazhohen nëpërmjet partneriteteve dhe punës shumë aktoriale, për të dëgjuar, mësuar dhe reaguar më me efikasitet ndaj të gjitha sfidave dhe kërcënimeve. Këtë filozofi ne e kemi bërë tashmë realitet edhe nëpërmjet nismave sikurse është ajo për pilotimin e modelit MASH në Bashkinë Elbasan.

Ju uroj një lexim të këndshëm.

Sinqerisht,

Gledian Llatja

Kryetar i Bashkisë Elbasan

DEAR READERS



“ As a critical tool to continuously improve our security enhancement efforts, stakeholders locally and beyond must be engaged through partnerships and multi-stakeholder work; to listen, learn and respond more effectively to all challenges and threats.

Mr. Gledian Llatja

I am pleased to introduce to you the 3rd issue of the Local Public Safety Council Bulletin. As the Mayor of Elbasan Municipality and at the same time of the KVSP mechanism, I consider our common communication to be very important in identifying and addressing the challenges of concern for all of us, where this mechanism also serves as a connecting bridge to be closer to each other.

In this issue, you will have the opportunity to know closely the importance and activities developed by this mechanism as well as some of the very important initiatives undertaken by the Elbasan Municipality, such as the development of sustainable volunteering, strengthening relations with the diaspora, the development of new partnerships and the strengthening of existing ones, the increase of cooperation with local actors as well as the inclusion and empowerment of young people in decision-making.

In the following pages, you will be introduced to the extraordinary work and achievements that all members of this mechanism and our collaborators do to identify and address as effectively as possible the challenges related to security, supporting every initiative that prevents and fights factors that compromise security. We appreciate that, through this

mechanism, our partners have found a very good way to increase the efficiency of their work.

As a critical tool to continuously improve our security enhancement efforts, stakeholders locally and beyond must be engaged through partnerships and multi-stakeholder work; to listen, learn and respond more effectively to all challenges and threats. We have already made this philosophy a reality through initiatives such as the one for piloting the MASH model in Elbasan Municipality.

I wish you a pleasant reading.

Sincerely,

Gledian Llatja

Mayor of Elbasan Municipality

FJALA PËRSHËNDETËSE E Z. MICHELE RIBOTTA, PËRFAQËSUES I UN WOMEN NË SHQIPËRI



z. Michele Ribotta

Gjatë dekadës së fundit, UN Women dhe Bashkia Elbasan bashkërisht kanë punuar për t'i dhënë prioritet barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Duke sjellë ekspertizën tonë së bashku me autoritetet vendore, shoqërinë civile, sektorin privat, universitetin dhe partnerë të tjerë në Elbasan, më shumë gra po marrin kontrollin mbi jetën e tyre. Më shumë gra po dalin nga marrëdhëniet abuzive, më shumë gra kanë një zë në vendimmarrje, më shumë gra rurale po marrin iniciativë dhe përgjegjësi, dhe më shumë gra po mbajnë role drejtuese.

Në Elbasan kemi fokusuar punën tonë në pjesëmarrjen e grave në qeverisjen dhe vendimmarrjen vendore, ofrimin e shërbimeve, luftën ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, fuqizimin e grave, punët e gjelbra dhe të drejta, përfshirjen sociale, si dhe planifikimin urban vendor.

Dy vite më parë kemi rinovuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Bashkinë Elbasan për të kryer aktivitete të përbashkëta në kuadër të programeve zhvillimore të UN Women. Nëpërmjet programit "BE për Barazinë Gjinore në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian (BE), në kemi mbështetur zhvillimin dhe miratimin e Planit të dytë të Veprimit Vendor të Barazisë Gjinore. Ky Plan është vendimtar për zbatimin e Kartës Evropiane për Barazinë ndërmjet grave dhe burrave në jetën vendore. Në kuadër të këtij projekti, 40 gra nga Njësia Administrative Labinot-Mal, të cilat janë pa mbështetje tjetër financiare ose në vështirësi ekonomike, u mbështetën përmes zhvillimit të zinxhirit të vlerës së perimeve. 40 gratë përfituese kanë rritur njohuritë e tyre në bujqësi dhe marketing, duke ndikuar kështu

në pavarësinë e tyre financiare dhe mundësitë për të rritur të ardhurat. Ju mund të ndihmoni fuqizimin e këtij grupi duke mbështetur markën e tyre të sapokrijuar vendore "Produkte Labinoti".

Një tjetër zinxhir vlerash për perimet e prodhuara në zonë është ende duke u hartuar për Shirgjanin, përmes projektit të UN Women dhe FAO "Fuqizimi i grave në zonat rurale dhe turizmi", i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Së shpejti, një inkubator do të jetë në funksion për të ndihmuar gratë të përmirësojnë ruajtjen, paketimin dhe tregtimin e prodhimeve të tyre lokale.

Projekti mbështet gjithashtu ngritjen e grupit vendor të veprimit në Elbasan, si një nismë e Bashkisë dhe e komunitetit lokal, që ka për qëllim nxitjen e vendimmarrjes sipas parimit nga poshtë-lart.

Nga ana tjetër, UN Women bashkëpunon gjerësisht me OJF-të lokale, si Forumi i Gruas Elbasan dhe Tjetër Vizion, për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave, përmes projekteve të ndryshme të mbështetura nga BE dhe Qeveria Suedeze. Kjo mbështetje përfshin asistencën dhe shërbimet e specializuara mbështetëse për gratë e mbijetuara të dhunës dhe zhvillimin e modeleve efektive të riintegritimit. Gjithashtu, fushatat ndërgjegjësuere dhe sesionet informuese mbi dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore janë në vazhdim në zonat urbane dhe peri-urbane, me fokus gratë dhe vajzat e marginalizuara.

Nëpërmjet projekteve tona për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, UN Women po ofron mbështetje dhe ekspertizë teknike administratës vendore mbi integrimin e perspektivës gjinore, buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, përdorimin e mjeteve të ndryshme analitike gjinore për hartimin, planifikimin dhe monitorimin e politikave vendore.

Ekipi i UN Women në Shqipëri mirëpret vazhdimin e këtij partneriteti dhe bashkëpunimi shumë të frytshëm me Bashkinë e Elbasanit, për të promovuar më tej barazinë e plotë midis grave dhe burrave në të gjithë komunitetin.

Michele Ribotta
Përfaqësues i UN Women në Shqipëri

WELCOME SPEECH BY MICHELE RIBOTTA, REPRESENTATIVE OF UN WOMEN ALBANIA



Mr. Michele Ribotta

Over the last decade, UN Women and the Municipality of Elbasan have joined forces to prioritize made gender equality and the empowerment of women. By bringing our expertise and resources together with local authorities, civil society, the private sector, academia, and other partners in Elbasan, more women are taking control over their own lives: More women are coming out of abusive relationships, more women are having a voice in decision-making, more women in rural areas are taking ownership, and more women are holding leadership positions.

In Elbasan we focus our work women participation in local government and decision making, service provision, violence against women and domestic violence, women's economic empowerment, green jobs and decent work, social inclusion, urban and local planning.

Two years ago, we renewed the Memorandum of Understanding with the Municipality of Elbasan to carry out joint activities in the framework of various UN Women programmes. Through the "EU for Gender Equality in Albania" program, funded by the European Union (EU), we supported the development and the adoption of the second Local Gender Action Plan. This Plan is crucial for the implementation of the European Charter for Equality between Women and Men in Local Life. Under the same project, 40 women from Labinot-Mal Administrative Unit, who are without other financial support or in economic difficulties,

were supported through the development of the vegetables value chain. They gained knowledge in agriculture and marketing and are better equipped to be financially independent and earn more income. You can help empower this group by supporting their newly established local brand "Produkte Labinoti".

Another value chain of locally produced vegetables is being developed in Shirgjan, through the UN Women-FAO project "Gender Rural Equality and Tourism", funded by Italian Agency for Development Cooperation. An incubator will soon start functioning there to help women improve the storing, packaging and marketing of their local vegetable produce. The project is also supporting the establishment of the local action group in Elbasan, as an initiative of the municipality and the local community to promote bottom-up decision making.

UN Women extensively collaborate with local CSOs, such as Woman Forum Elbasan and Tjetër Vizion, through various projects on ending violence against women, supported by EU and the Swedish Government. This includes assistance and specialized support services to women survivors of violence, and develop effective reintegration models. Awareness campaigns and information sessions on domestic and gender-based violence are ongoing in urban and uptown areas, reaching out to marginalized women and girls.

Through our projects on gender responsive budgeting, UN Women has been providing technical and expert support to local public administration on gender mainstreaming, gender responsive budgeting, use of different gender analytical tools for design, planning and monitoring of local policies.

The UN Women team in Albania looks forward to continuing this very fruitful partnership and collaboration with the Municipality of Elbasan, to promote full equality between women and men in the entire community.

Michele Ribotta
UN Women Albania Representative

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË DREJTORISË VENDORE TË POLICISË ELBASAN, Z. ARDIAN ÇIPA



Drejtues i Parë z. Ardian Çipa

Të dashur bashkë qytetarë të Elbasanit, Është nder, privilegj dhe mbi të gjitha përgjegjësi të jem pjesë e rëndësishme e Këshillit Vendor të Sigurisë si një përpjekje për ritjen e forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe marrjen e vendimeve në të mirë të qytetarëve. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike i ngritur që në vitin 2016 në Bashkinë Elbasan, është një institucion tashmë, që Bashkia Elbasan ofron si një model pozitiv lidhur me trajtimin e të gjitha problematikave dhe qasjen e një bashkëjetese komunitare në përpjekje të plotësojë standartet e nevojshme. Kjo nisimë, përkthehet në një bashkëpunim të shkëlqyer ndër-institucional me qëllim ofrimin e shërbimeve që konsistojnë në adresimin e problemeve, fenomeneve si dhe sfidave, parandalimin e kriminalitetit, mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve.

Nisur nga misioni ynë sa i vështirë dhe fisnik, jemi përpjekur të jemi bashkëpunues aktivë me institucionet por edhe transparentë me publikun dhe të qartë si pjesë e KVSP, duke treguar se lufta jonë ndaj krimit do të jetë e vazhdueshme, e pa ndërprerë dhe me qasje ndër-institucionale ku krahas masave penale ndaj autorëve dhe grupeve të implikuara në

“...Bashkia Elbasan ofron si një model pozitiv lidhur me trajtimin e të gjitha problematikave dhe qasjen e një bashkëjetese komunitare në përpjekje të plotësojë standartet e nevojshme.

aktivitet kriminal qasje specifike gjykojmë se duhet të ketë edhe në aspektin social, e analitik të fenomeneve antishoqërore me qëllim forcimin e masave parandaluese dhe rehabilituese. Është angazhim dhe detyrim i yni që në radhë të parë si qytetarë, prindër, dhe drejtues institucionesh t’ju tregojmë të rinjve një model sa më të shëndoshë, larg veseve, apo rrugëve të paligjshme për tu përfshirë e pasuruar duke ju bërë të qartë pasojat që në shumë raste bëhen të pa riparueshme dhe do t’i përndiqnin gjatë gjithë rrugëtimit të tyre. Prej shumë vitesh nga DVP Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore realizohen takime periodike me nxënësit e shkollave 9-vjeçare, të shkollave të mesme dhe të larta, ku temat më të spikatura janë efektet negative të lëndëve narkotike, alkoolit, duhanit dhe rregullat e qarkullimit rrugor dhe rëndësia e respektimit rigoroz të tyre.

Qëllimi dhe synimi i këtyre takimeve ka të bëjë me ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e të rinjve duke i orjentuar ata drejt aktiviteteve dhe programeve të cilat ofrojnë modele pozitive dhe një jetë sa më të shëndetshme. Gjithashtu dua të sjell në vëmendje që gjatë takimeve të KVSP është bërë i mundur edhe prezantimi i

projektit RAYS i cili aktualisht po zbatohet në partneritet midis Bashkisë Elbasan dhe grupit Palladium, me qendër në Londër. Ky projekt synon parandalimin e angazhimit të të rinjve në krimin e organizuar, ngritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe anëtarëve të KVSP-së si edhe zhvillimin e përforcimin e partneriteteve të mëtejshme. Falë frymës së bashkëpunimit dhe marrjes së përgjegjësisë të institucioneve si Bashkia Elbasan, DVP Elbasan, Drejtoria Arsimore, dhe Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor ky projekt është duke u implemetuar sipas modelit MASH i prezantuar nga ekspertët anglezë.

KVSP është një mekanizëm që bën të mundur identifikimin dhe adresimin e problemeve që çenojnë jetesën dhe sigurinë e komuniteteve, ku një fokus të veçantë kanë viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët në situatë rruge. Për këtë qëllim bashkëpunimi ynë me të gjitha institucionet ligjzbatuese, me institucionin e bashkisë, qendrat e ofrimit të shërbimeve etj do të jetë i vazhdueshëm e i përhershëm me synimin për t'i ofruar viktimave të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, apo fëmijëve në situatë rruge mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve emergjente dhe të nevojshme, të cilat realizohen falë "Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje", apo Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Elbasan, pa harruar mbështetjen e aktorëve të tjerë të cilët ofrojnë shërbime dhe mbështetje për këto raste.

Takimet e organizuara nga KVSP na venë të gjithëve përpara përgjegjësisë për të marrë përsipër detyrimet dhe angazhimet tona institucionale, me qëllim pasqyrimin e një realiteti sa më të saktë. Na bëjnë të ndërgjegjshëm se ku kemi avancuar, ku kemi fituar, por edhe ku mund ta

përmirësojmë punën tonë, kjo e pasqyruar më së miri edhe në dëgjesat publike ku të gjithë duhet të jemi transparentë dhe të japim një panoramë sa më të qartë për komunitetin.

Në rrugën e gjatë që kemi përpara kemi motivimin e rezultateve të mira që kemi arritur, por kemi dhe pasurinë e madhe të eksperiencës prej gabimeve të bëra. Dallimin në funksion të së ardhmes e bën vetëm një gjë, vetëdija për gabimet, eksperiencia nga humbjet dhe vendosmëria për të mos përsëritur të njëjtat gabime dhe për të mos humbur për të njëjtat arsye. Ne, ju siguroj, kemi aftësinë për ta bërë këtë dallim dhe mbi këtë dallim do të ngremë më tutje ngrehinën europiane të bashkëpunimit ndërinstytucional për të realizuar misionin tonë në ndihmë e për qytetarët. Është detyrim dhe angazhim i institucionit të DVP Elbasan, për të ofruar një shërbim sa më të mirë për qytetarët, për t'ju ofruar një mjedis sa më të qetë dhe të sigurtë, por kjo mund të realizohet vetëm duke qënë të gjithë së bashku në anën e duhur si aleatë të një komuniteti me qytetari, me mikpritje, parime dhe intelekt me frymën e paqes dhe të respektit për njëri-tjetrin duke i bërë bllok të gjitha përpjekjeve për të prishur imazhin, qetësinë dhe jetesën e përbashkët në një komunitet arsim-dashës dhe të kulturës siç janë qytetarët e Elbasanit.

Jam i sigurt që të gjithë sëbashku mund të bëjmë shumë për një komunitet të sigurt.

**Me konsideratë
Drejtues i Parë Ardian Çipa**

WELCOME SPEECH OF THE DIRECTOR OF THE LOCAL POLICE DIRECTORATE OF ELBASAN, MR ARDIAN ÇIPA



First Director Mr Ardiان Çipa

“...Elbasan Municipality offers as a positive model regarding the treatment of all problems and the approach of community coexistence to meet the necessary standards.

Dear fellow citizens of Elbasan,

It is an honour, a privilege and, above all, a responsibility to be an important part of the Local Safety Council as an effort to increase and strengthen inter-institutional cooperation and make decisions for the benefit of citizens. The Local Public Safety Council, established in 2016 in Elbasan Municipality, is an institution that Elbasan Municipality offers as a positive model regarding the treatment of all problems and the approach of community coexistence to meet the necessary standards. This initiative translates into an excellent inter-institutional cooperation to provide services that consist of addressing problems, phenomena and challenges, preventing criminality, and protecting the life and property of citizens.

Based on our difficult and noble mission, we have tried to be active collaborators with the institutions but also transparent with the public and clear as part of the LPSC, showing that our fight against crime will be continuous, uninterrupted and with an inter-institutional approach where, in addition to criminal measures against perpetrators and groups implicated in criminal activity, we believe that there should be a specific

approach in the social and analytical aspects of anti-social phenomena to strengthen preventive and rehabilitative measures. First of all, it is our commitment and obligation as citizens, parents, and leaders of institutions, we show young people a model that is as healthy as possible, away from vices or illegal ways to get involved and get rich, making the consequences clear that in many cases become irreparable and would haunt them throughout their journey. For many years, the Local Police Directory (LPD), in cooperation with the Education Directorate, has been holding periodic meetings with students of 9th-grade schools, high schools, and universities where the most prominent topics are the negative effects of narcotics, alcohol, tobacco and traffic rules. and the importance of their strict observance.

The purpose and aim of these meetings are about raising awareness and sensitizing young people, orienting them towards activities and programs that offer positive models and healthier life. I also want to draw attention to the fact that during the LPSC meetings, it was possible to present the Rays project, which is currently being implemented in partnership between the Elbasan Municipality and the Palladium

group, based in London. This project aims to prevent the involvement of young people in organized crime, increase the capacities of the institutions and members of the LPSC, as well as the development and strengthen further partnerships. Thanks to the spirit of cooperation and taking on the responsibilities of institutions such as Elbasan Municipality, LPD Elbasan, the Directorate of Education, and the Directorate of Health Care, this project is being implemented according to the MASH model presented by English experts.

LPSC is a mechanism that makes it possible to identify and address problems that affect the livelihood and security of communities, where victims of domestic violence and children in street situations have a special focus. For this purpose, our cooperation with all law-enforcement institutions, with the institution of the municipality, service delivery centres, etc. will be continuous and permanent to offer victims of domestic and gender-based violence, or children in street situations through the protection and provision of emergency and necessary services, which are realized thanks to the "Mechanism for Coordination and Referral of Cases of Domestic Violence", or the Child Protection Unit in Elbasan Municipality, without forgetting the support of other actors who provide services and support for these cases.

The meetings organized by LPSC put all of us in front of the responsibility to assume our institutional obligations and commitments, to reflect reality as accurately as possible. They make us aware of where we have advanced, where we have won, but also where we can

improve our work, this is best reflected in the public hearings where we all have to be transparent and give the clearest overview for the community.

In the long road ahead of us, we have the motivation for the good results we have achieved, but we also have a great wealth of experience from the mistakes made. The difference because of the future is made by only one thing, awareness of mistakes, experience from losses and determination not to repeat the same mistakes and not to lose for the same reasons. We, I assure you, can make this difference and on this difference, we will further raise the European edifice of inter-institutional cooperation to realize our mission to help the citizens. It is the obligation and commitment of the institution of LPD Elbasan, to offer the best possible service to the citizens, and to offer you an environment as calm and safe as possible, but this can only be achieved by being all together on the right side as an ally of a community with citizenship, hospitality, principles and intellect with the spirit of peace and respect for each other, blocking all efforts to destroy the image, tranquility and common life in an educational community - loving and cultural like the citizens of Elbasan.

I am sure that together we can do a lot for a safe community.

With consideration
First Director Ardian Çipa

RËNDËSIA E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË ELBASAN (NGA Z. ERVIN MUÇO)



Mr. Ervin Muço

“...ky mekanizëm ofron një sërë modelesh të thelluara për ndërtimin e kapaciteteve, ndërhyrje si edhe angazhim të rinjve.

Tendencat e fundit në parandalimin e krimit dhe sigurinë e komunitetit në Shqipëri janë karakterizuar nga ndikimi i ideve për përfshirjen e pushtetit lokal, institucioneve publike, shoqërisë civile dhe komunitetin në përcaktimin e prioriteteve për sigurinë. Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP) shërbejnë si një organ konsultativ në çështjet e lidhura me sigurinë. Ato i ndihmojnë anëtarët e tyre që të bashkëpunojnë me komunitetet për të hartuar dhe vendosur përgjigje lokale ndaj këtyre sfidave komplekse, duke siguruar që asnjë qytet të mos përballet i vetëm me këto kërcënime.

KVSP Elbasan është zhvilluar nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm të partneriteteve të hershme dhe ndërtimit të atyre të reja, në nivel lokal, kombëtar e përtej. Nëpërmjet takimeve periodike, shkëmbimeve të qyteteve, workshopeve, partneriteteve me organizata të shoqërisë civile, janë ndërtuar ura komunikimi, diskutuar ide inovative dhe shkëmbyer praktika të mira me homologë dhe ekspertë vendas e të huaj në këtë fushë.

Gjithashtu, ky mekanizëm ofron një sërë modelesh të thelluara për ndërtimin e kapaciteteve, ndërhyrje si edhe angazhim të rinjve në proceset vendimmarëse. Duke i përshtatur qasjet ekzistuese për bashkëpunim me agjenci të ndryshme, ne punojmë në partneritet të ngushtë me autoritetet e qeverisjes qendrore dhe lokale, me shoqërinë civile, komunitetet dhe liderët fetarë.

Qëllimi ynë është të sigurojmë që nëpërmjet mekanizmit të KVSP-së të mund të projektojmë, vendosim dhe japim përgjigje efektive sfidave

komplekse të lidhura me sigurinë. Në këtë kontekst puna e KVSP-së është fokusuar në:

- **Hartimin e strategjive dhe politikave për adresimin e problematikave të lidhura me sigurinë si p. sh. pilotimi i modelit “MASH” për mbrojtjen e fëmijëve; Hartimi i strategjisë së vlerësimit të riskut; Hartimi i strategjisë së komunikimit etj;**
- **Ndërtimi i një infrastrukture parandaluese që përfshin punën nga poshtë lart.** Prej një periudhe më shumë se një vjeçare janë ngritur dhe bërë funksionale strukturat komunitare si edhe është zhvilluar më tej partneriteti me aktorë të shoqërisë civile;
- **Shkëmbimi i informacionit, puna kërkimore-shkencore dhe ofrimi i ekspertizës.** KVSP vlerëson punën kërkimore dhe praktikën e mira të siguruar nga partnerët dhe aktorët e ndryshëm publikë e jo-publikë gjë që mundëson hartëzimin e problematikave dhe ofrimin e një qasje sa më efektive për zgjidhjen e tyre.
- **Forcimi i partneriteteve brenda dhe jashtë Shqipërisë si edhe zbatimin e projekteve të përbashkëta;**
- **Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve duke organizuar workshope e trainime në nivel strategjik dhe teknik.**

Në këtë mënyrë KVSP mundëson krijimin e komunitete më të sigurta dhe marrjen e masave për parandalimin e krimit.

Ervin Muço
Koordinator i KVSP Elbasan

THE IMPORTANCE OF THE LOCAL PUBLIC SAFETY COUNCIL IN ELBASAN MUNICIPALITY (BY MR. ERVIN MUÇO)



“...this mechanism offers a series of in-depth models for capacity building, intervention and youth engagement.”

Mr. Ervin Muço

Recent trends in crime prevention and community safety in Albania have been characterized by the influence of ideas on the involvement of local government, public institutions, civic society and the community in determining security priorities. Local Public Security Councils (LPSC) serve as a consultative body on security-related issues. They help their members collaborate with communities to design and implement local responses to these complex challenges, ensuring that no city faces these threats alone.

LPSC Elbasan has developed through the further consolidation of early partnerships and the construction of new ones, locally, nationally and beyond. Through periodic meetings, city exchanges, workshops, partnerships with civil society organizations, bridges of communication have been built, innovative ideas discussed and good practices exchanged with local and foreign counterparts and experts in this field.

Also, this mechanism offers a series of in-depth models for capacity building, intervention and youth engagement in decision-making processes. Adapting existing approaches to collaboration with different agencies, we work in close partnership with central and local government authorities, civil society, communities and religious leaders.

Our goal is to ensure that through the LPSC mechanism we can design, deploy and provide effective responses to complex security-related challenges. In this context, the work of LPSC is focused on:

- **Drafting of strategies and policies for addressing issues related to security**, such as sh. piloting the “MASH” model for child protection; Drafting of the risk assessment strategy; Designing the communication strategy;
- **Building a preventive infrastructure that includes bottom-up work.** For a period of more than a year, the community structures have been set up and made functional, and the partnership with civil society actors has been further developed.
- **Exchange of information, research-scientific work and provision of expertise.** KVSP evaluates the research work and good practices provided by partners and various public and non-public actors, which enables the mapping of problems and providing the most efficient approach to their solution.
- **Strengthening of partnerships inside and outside Albania as well as the implementation of joint projects;**
- **Training and capacity building by organizing workshops and trainings at a strategic and technical level.**

In this way, KVSP enables the creation of safer communities and taking measures to prevent crime.

Ervin Muço
Coordinator of LPSC Elbasan

FORUM I HAPUR ME TË RINJTË E QYTETIT TË ELBASANIT

Kryetari i Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja, Ambasadori Alastair King-Smith, Drejtuesi i Prokurorisë së Shkallës së Parë Elbasan, z. Kreshnik Ajazi dhe Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, Drejtuesi i Parë Z. Ardian Çipa, zhvilluan një forum të hapur me të rinjtë e qytetit të Elbasanit dhe organizatat vendore. Në fokus të këtij forumi ishin çështjet e lidhura me sigurinë si edhe inkurajimi i të rinjve dhe organizatave që të bëhen zëra të fortë brenda komuniteteve të tyre, të kërkojnë më shumë llogaridhënie nga institucionet, të ndërmarrin veprime të përgjegjshme dhe të angazhohen në vendimmarrje.

Ambasadori King-Smith theksoi se: "Jemi të vendosur të promovojmë më shumë mundësi zhvillimi në Shqipëri dhe kjo nuk reflektohet askund më mirë se në nismën tonë të sapo nisur në Kukës dhe në projektin RAYS, Reconnecting Albanian Youth and Society, i cili ka bërë një punë të mrekullueshme në komunitetin tuaj duke promovuar përfshirje dhe kohezionin social. Ne duam të frymëzojmë të rinjtë në Shqipëri që të kontribuojnë në vendin e tyre dhe të krijojnë partneritete të qëndrueshme për të ardhmen".

Ndërkohë kryetari i bashkisë z. Llatja theksoi se: "Çështjet rinore tani mund të adresohen më lehtë falë politikave tona të reja dhe të përfshihen në planifikimin dhe buxhetimin e nivelit vendor. Ndaj në qendër të punës sime në këtë mandat të parë ishte fuqizimi i tyre duke i dhënë një vend të veçantë zërit të tyre në vendimmarrje, duke marrë një rol aktiv në nivel lokal për të ndjekur projektet që lidhen me rininë."

Në fjalën e tij drejtuesi i Prokurorisë Z. Kreshnik Ajazi theksoi se "institucioni ynë ndjek me kujdes çështjet penale duke i dhënë atyre një vëmendje të veçantë dhe se do të vazhdojmë të jemi pjesë e rrjetit të partneritetit me aktorët vendor që kanë në fokus të rinjtë në mënyrë që tu sigurojmë atyre një të ardhme si anëtarë të një shoqërie të shëndetshme dhe të sigurtë".

Drejtori i DVP Elbasan, z. Çipa i garantoi të rinjtë se strukturat e DVP Elbasan do të vijojnë me përkushtim dhe profesionalitet, angazhimin e tyre në mbrojtje të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe për moslejimin e depërtimit të fenomeneve kriminale, te ata.

Projekti "RAYS - Rilidhja e Rinisë dhe Shoqërisë Shqiptare", i mbështetur nga Mbretëria e Bashkuara dhe i zbatuar nga Palladium Group synon të përkrahë të rinjtë shqiptarë të përmbushin aspiratat e tyre për të ndikuar pozitivisht në komunitetet ku jetojnë.



OPEN FORUM WITH THE YOUNG PEOPLE OF THE CITY OF ELBASAN

Mayor of Elbasan Mr Gledian Llatja, Ambassador Alastair King-Smith, Head of the Elbasan First Instance Prosecution, Mr Kreshnik Ajazi and the Director of the Elbasan Local Police Directorate, First Director Mr Ardian Çipa, held an open forum with the youth of the city of Elbasan and local organizations. The focus of this forum was on issues related to security as well as encouraging young people and organizations to become strong voices within their communities, demanding more accountability from institutions, taking responsible actions and engaging in decision-making.

Ambassador King-Smith emphasized that: "We are determined to promote more development opportunities in Albania and this is reflected nowhere better than in our newly launched initiative in Kukës and the RAYS project, Reconnecting Albanian Youth and Society, which has done great work in your community promoting inclusion and social cohesion. We want to inspire young people in Albania to contribute to their country and create sustainable partnerships for the future".

Meanwhile, the mayor Mr Llatja emphasized that: "Youth issues can now be addressed more easily thanks to our new policies and be included in planning and budgeting at the local level. So at the centre of my work in this first term was empowering them by giving a special place to their voice in decision-making, taking an active role at the local level to follow projects related to youth."

In his speech, the head of the Prosecutor's Office Mr Ajazi emphasized that "our institution carefully follows criminal cases, giving them special attention and that we will continue to be part of the partnership network with local actors that focus on young people to provide them with a future as members of a healthy and safe society".

The director of LPD Elbasan, Mr Çipa assured the young people that the structures of LPD Elbasan will continue with dedication and professionalism, to protect children and young people, as well as to prevent the penetration of criminal phenomena among them.

The "RAYS - Reconnecting Albanian Youth and Society" project, supported by the United Kingdom and implemented by the Palladium Group, aims to support young Albanians to fulfil their aspirations to positively influence the communities where they live.



KËSHILLI VENDOR I SIGURISË PUBLIKE NË 1 VIT

I themeluar që në vitin 2016, Këshilli Vendor i Sigurisë Publike është, tashmë, një mekanizëm funksional që mundëson mbledhjen, angazhimin dhe bashkëpunimin e aktorëve lokalë e më gjerë në funksion të adresimit të çështjeve të lidhura me sigurinë.

Gjatë vitit 2022, nën drejtimin e Z. Gledian Llatja, njëkohësisht Kryetar i KVSP-së, janë zhvilluar takime, trajnime për ngritje kapacitetesh, vizita studimore si edhe projekte në partneritet me OShC dhe konkretisht:

- 4 takime periodike për identifikimin dhe adresimin e problematikave të ndryshme të lidhura me sigurinë;
- 1 takim i hapur me Komisionin Parlamentar të Sigurisë;
- 1 forum qytetar;
- 2 trainime me të rinjtë e Këshillit Rinor Elbasan;
- 1 trajnim me ndërlidhësat komunitarë;
- 6 Workshope me anëtarë të KVSP në nivel strategjik dhe teknik; si edhe
- 4 takime për treguesit e performancës me: Drejtoria Rajonale e Punësimit Elbasan, Shëndetin Publik, Zyrën Vendore Arsimore Elbasan, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Drejtorinë Rajonale të Policisë Elbasan).



LOCAL PUBLIC SAFETY COUNCIL IN 1 YEAR

Established in 2016, the Local Public Safety Council is today a functional mechanism that enables the gathering, engagement and cooperation of local and wider actors to address safety-related issues.

During the year 2022, meetings, training for capacity building, study visits as well as projects in partnership with CSOs were held by this mechanism, specifically:

- 4 periodic meetings to identify and address various issues related to security;
- 1 open meeting with the Parliamentary Security Committee;
- 1 public forum;
- 2 trainings with the youth of the Elbasan Youth Council;
- 1 training with community liaisons;
- 6 Workshops with KVSP members at the strategic and technical levels; and
- 4 meetings for performance indicators with Elbasan Regional Employment Directorate, Public Health, Elbasan Local Education Office, Elbasan Judicial District Prosecutor's Office and Elbasan Regional Police Directorate).



AKTIVITETE

1. VIZITË STUDIMORE NË MBRETËRINË E BASHKUAR



- **Ben Snuggs**, zv. Komisar i policisë së Hampshire, i cili shpjegoi rëndësinë e partneritetit mes të gjithë aktorëve përgjegjës në reagimin mbrojtës për fëmijët në rrezik;
- **Donna Jones**, Komisionere e Policisë dhe Krimin në Hampshire;
- Ekipin e MASH Hampshire, përfaqësuesin e policisë **Tom Hewitt** dhe nga shërbimi i fëmijëve **Neil Connolly** të cilët e njohën delegacionin me praktikën e trajtimit të rasteve për fëmijët dhe të rinjtë që janë

Në kuadër të projektit “Rilidhja e Rinisë dhe Shoqërisë Shqiptare” (RAYS), mbështetur nga Qeveria Britanike, i cili po zbatohet edhe në Bashkinë Elbasan, një delegacion i kryesuar nga kryetarët e bashkive Elbasan, Shkodër e Kukës, përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, drejtues të lartë të Policisë së Shtetit, Shërbimit Social e Drejtorive Arsimore zhvilluan, në datën 26-30 Shtator 2022, një vizitë studimore në Mbretërinë e Bashkuar për tu njohur nga afër funksionimin e modelit të partneritetit në reagimin mbrojtës ndaj fëmijëve (MASH), i cili është duke u zbatuar edhe në Bashkisë Elbasan pranë Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve. Gjatë vizitës studimore delegacioni shqiptar zhvilloi takime me:





të shfrytëzuar, trafikuar apo përfshirë në krimin e rëndë dhe të organizuar.

- **Dr. Richard John**, nga policia e Southampton, i cili prezantoi rrugëtimin

e gjatë të MASH në UK dhe orientimin strategjik mbi domosdoshmërinë e bashkëpunimit mes të gjithë aktorëve në MASH.

- **Eileen Calnan** e cila shpjegoi qasjen e skuadrave të investigimit të abuzimit të fëmijëve dhe bashkëpunimin me agjencitë e tjera partnere që nga hetimi, mbrojtja dhe mbështetja e ofruar.
- Delegatët e Komisionit Rinor të Hampshire Hampshire and Isle of Wight Youth Commission, **Lynne, Bradley** dhe **Casey**, një strukturë që bashkëpunon ngushtësisht me Komisionerin e Policisë dhe Krimin, dhe përcjell zërin e të rinjve; dhe
- **Adrian Kingswell**, përfaqësues i "Zgjidhje të Qëndrueshme të Drejtësisë Penale" (Sustainable Criminal Justice Solutions - SCJS).

Gjithashtu, delegacioni u njoh nga afër me punën e **St Giles Trust**, një organizatë kombëtare që punon me të rinjtë që janë në rrezik për t'u përfshirë në krimin e rëndë dhe të organizuar.

2. AKTIVITETET E ZHVILLUARA NGA PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN



Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, gjatë vitit 2022, përveçse ka luftuar

krimin ka pasur në fokus kryesor dhe viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë për shkak të gjinisë së tyre, si dhe të miturit. Për këtë arsye ky institucion është treguar i gatshëm për të bashkëpunuar me insitucione apo organizata të shoqërisë civile dhe gjithashtu ka qenë aktiv duke ndërmarrë iniciativa për të organizuar takime të ndryshme në kuadër të informimit të të rinjve rreth funksionit të prokurorisë dhe rritjes së besimit ndaj këtij institucioni.

Në këtë kontekst, Drejtuesi i Prokurorisë së Shkallës së Parë Elbasan, ka ndjekur nga afër të gjitha takimet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike ku është diskutuar rreth sigurisë

në territorin e Bashkisë Elbasan, është ri-nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për Mekanizmit e Referimit të Dhunës në Familje me Bashkinë e Elbasanit, si edhe pjesëmarrja në forumin publik llogaridhënie publike dhe transparencë të organizuar nga KVSP.

Një vëmendje e veçantë është kushtuar komunikimit me të rinjtë në kuadër të të cilit janë zhvilluar takime të hapura me studentë të Departamentit të Drejtësisë në Universitetin e Elbasanit; me nxënësit e klasave të nënta, të katër shkollave të qytetit të Elbasanit, të cilët drejtuan pyetje dhe diskutua rreth sigurisë së tyre; takime informuese me nxënësit e gjimnazit "Dhaskal Todri". Në këto takime kanë marrë pjesë edhe stafet pedagogjike, punonjësit e shërbimeve psiko-sociale, oficerët e sigurisë së shkollës dhe përfaqësues të këshillit të prindërve; takim me nxënësit e shkollës "Ali Agjah", në prezencë dhe punonjësve psiko – social dhe përfaqësues të stafit pedagogjik.

Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura midis Prokurorisë dhe shoqatave që operojnë në Qarkun e Elbasanit si edhe me praninë e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe Bashkisë Elbasan është zhvilluar takim ku është diskutuar rreth ecurisë së bashkëpunimit dhe përmirësimit të tij.



Gjithashtu, Z. Ajazi ka zhvilluar takime me përfaqësues të shërbimit psiko-social të shkollave të qytetit të Elbasanit dhe me oficerët e sigurisë së gjimnazeve të qytetit të Elbasanit ku është diskutuar rreth rëndësisë që ka evidentimi dhe referimi i rasteve nga ana e tyre.

Në kuadër të 16 ditëve të "Aktivizmit të Dhunë me Bazë Gjinore", në ambientet e shoqatës "Forumi i Gruas Elbasan" Z Ajazi zhvilloi një takim me gratë viktime të dhunës në familje.

3. DREJT NJË PARTNERITETI PËR VULLNETARIZËM TË QËNDRUESHËM



Kryetari i Bashkisë z. Gledian Llatja mori pjesë në konferencën me temë "Paqja dhe Demokracia nëpërmjet Vullnetarizmit" të

zhvilluar në qytetin e Tiranës më Shtator 2022. Në këtë konferencë, z. Llatja ndau me panelin përvojën e mirë që ka ndërmarrë Bashkia Elbasan, duke e vënë theksin tek vullnetarizmi i qëndrueshëm, angazhimi institucional dhe rolin e diasporës.

Në vijim të këtij eventi, Bashkia Elbasan në bashkëpunim me Punë Vullnetare Ndërkombëtare (PVN) dhe Lobi Euro-Atlantik Shqiptar, zhvilluan në qytetin e Elbasanit konferencën "Bashkërendim për Zhvillim Strategjik", ku diskutua rreth potencialeve të zhvillimit shoqëror në terma afatgjatë. Në këtë konferencë ishte prezent një delagacion nga qyteti i Kristiansand të Norvegjisë, i përfaqësuar nga z. **Erik Rostoft**,



nën-kryetari i Bashkisë së Kristiansand, z. **K Mørk**, përfaqësues i Partisë Laboriste, znj. **R Hægeland**, përfaqësuese e Partisë së Djathtë, z. **K H Gronert**, Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë së Kristiansand dhe z. **O Hortemo** nga shoqëria civile si edhe përfaqësues nga diaspora Shqiptare z. **D Haxhijaj** nga Lobi Euroatlantik Shqiptar dhe z. **A Ahmetaj** nga Bashkësia Kulturore Fetare Shqiptare në Kristiansand.

Në bisedat në vijim, me delegacionin Norvegjez, z. Llatja theksoi potencialet dhe burimet që ofron Bashkia e Elbasanit, si një ndër tre bashkitë më të mëdha në Shqipëri, me një histori dhe trashëgimi të pasur kulturore. Gjithashtu, ai theksoi prioritetet që ka për ta zhvilluar me tej Bashkinë e Elbasanit, duke vënë theksin tek projektet për rininë, artin dhe mbështetjen për shtresat në nevojë.



Ndër të tjera kryebashkiaku Llatja, bëri me dije se marrëdhënia e mirë mes dy qyteteve do të shtrihet në një tjetër nivel duke përfshirë projektet e përbashkëta të ndryshimeve klimaterike, shtimit të hapësirave të gjelbra, shërbimet e kujdesit social dhe vullnetarizmit.

Nga ana e tij Nënkyetari i Bashkisë së Kristiansand në Norvegji z. Rostoft në fjalën e tij falenderoi z. Llatja duke theksuar se:



“... të jesh kryebashkiak në detyrë, së bashku me gjithë kolegët tuaj është pozicioni i duhur ku mund të kuptosh njerëzit dhe problemet e tyre, por gjithashtu të përjetosh edhe kënaqësinë, pasi efiçenca politike është më e madhe. Dhe unë munda ta ndjej vërtetë, jo vetëm kur hyra në këtë zyrë, por munda të ndjej një qytet, ku, paçka se jam këtu prej pak orësh, unë ndjeva energji pozitive dhe në bisedat që patëm”.

4. PARK4YOUTH – NISMA E TË RINJVE PËR RIJETËZIMIN E HAPËSIRAVE TË PARKUT TË ELBASANIT, PARKU 'RINIA'



Një grup të rinjsh të mbështetur nga projekti i Qeverisë Britanike Rilidhja e Rinisë dhe Shoqërisë Shqiptare, RAYS kanë ndërmarrë nismën Park4Youth një nismë e cila përfshin fushatë advokimi dhe sensibilizimi për ta bërë parkun e qytetit më të aksesueshem nga të rinjtë, duke krijuar hapësira argetuese; fushatë pastrimi; pasurimi i parkut të qytetit me fidanë dhe aktivitete argëtuese nga të rinjtë për të rinjtë në parkun e qytetit. Iniciativa e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën INAC nisi rrugëtimin e saj me një tryezë diskutimi më përfaqësues të pushtetit vendor në Elbasan dhe gjimnazistëve të qytetit për orientimin e investimeve publike drejt përmirësimit të parkut të qytetit dhe për ta shndëruar atë në një mjedis miqësor me të rinjtë dhe mjedisin, në kuadër të nismës rinore Park4Youth – Parku Rinia.

Gjatë tryezës ku merrnin pjesë përfaqësues nga shoqëria civile, universiteti, institucionet

ligjzbatuese për sigurinë etj u diskutuan gjetjet e pyetësorit të realizuar me të rinjtë e gjimnazeve të qytetit të Elbasanit, të cilat kërkojnë investimeve konkrete nga Bashkia për ta kthyer parkun një hapësirë miqësore për të rinjtë.

“Park4Youth është një nismë që lindi nga një grup të rinjsh mbështetur nga projekti Rilidhja e Rinisë dhe Shoqërisë Shqiptare (RAYS), që ka si qëllim kryesor rijetëzimin e hapësirave të parkut të Elbasanit, Parku 'Rinia'. Synimi ynë është që të rritet niveli i sigurisë, të rritet frekuentimi nga të rinjtë, e të bëhet një park funksional, me të gjithë elementët që një park publik duhet të ketë. Unë jam shumë i lumtur që jam pjesë e këtij projekti dhe nisme, pasi kjo nismë që po ndërmarrim do të vlejë jo vetëm për brezin tonë të të rinjve, po për të gjithë komunitetin dhe për të gjithë brezat e ardhshëm, nëse këto investime do të merren seriozisht, apo nëse do të arrihet ndërgjegjësimi



I duhur qytetar për të patur një mbarëvajtje të mirë të këtyre investimeve” - shprehet Agim Gremi, pjesë e nismës Park4Youth në qytetin e Elbasanit.

Grupi i vullnetarëve dhe të rinjve që kryesojnë nismën Park4Youth, në koordinim me Bashkinë e Elbasanit, në fillim të muajit shkurt 2023 pastruan parkun e qytetit, pikturuan murale dhe mbollen pemë dekorative, duke i shtuar gjelbërimin parkut të qytetit. Në vazhdë të fushatës së pastrimit të parkut të qytetit nga të rinjtë, pasurimin e parkut të qytetit me pemë, parashikohen dhe aktivitete argëtuese nga të rinjtë për të rinjtë në parkun e qytetit.

Projekti i Qeverisë Britanike RAYS Rilidhja e Rinisë dhe Shoqërisë Shqiptare, që prej muajit Shtator 2022, po mbështet nismat rinore në qytetin e Elbasanit, Kukësit, dhe Shkodrës, nisma që mbështesin idetë e të rinjve (14-18 vjeç) për të zgjidhur një problematikë që do sjell ndryshim në komunitetin e tyre. Në qytetin e Elbasanit janë përzgjedhur 5 grupe të rinjsh, në total 24 të rinj në qytetin e Elbasanit, që mbështeten financiarisht nga RAYS për realizimin e projekte-ideve të tyre deri në shumën 2,500 Paund Britanike.

Iniciativat që RAYS mbështet në Elbasan janë:

